





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i biznesit:** "Company 21" Sh.p.k.  
**Numri Unik Identifikues:** 810488818  
**Drejtor:** Afërdita Saraqini Kelmendi  
**OSHMA:** Radio 21  
**Adresa:** Rr. Musa Tola, Lakrishte Llam B, Kati 17



**VENDIM**

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio 21, me seli në Prishtinë

**Fakte**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio 21 është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim nacional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Prishtinë. KPM, me 28 gusht 2016 ka bërë ripërtëritjen e licencës së Radio 21 për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 28 gusht 2023, skadon afati i licencës së Radio 21.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio 21, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 29 qershor 2023, Radio 21 ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.


**Arsyetim**

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio 21 lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.

7. Komisioni konstaton se, Radio 21 përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio).
8. Komisioni vlerëson se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial Radio 21, të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
9. Komisioni konstaton se Radio 21 ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
10. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së Radio 21.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio 21 është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio 21 i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut.

### Vendim

12. Komisioni në takimin e tij të datës 13 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës të Radio 21, në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) me mbulim nacional, e cila veprimtari është në interes të publikut.
13. Licenca e Radio 21 do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së Radio 21, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Jeton Mehmeti  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



13.09.2023  
Datë